



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me Nenin 1 paragrafi 1.3 Pika (ç) të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Duke pasur parasysh dispozitat e Ligjit për Organizatat Jo Qeveritare në Kosovës,

Me qëllim të përkrahjes financiare të zyrave të OJQ që veprojnë në shkallë vendi, dhe në pajtim me kërkesat e parashtruara, Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 3/2007
PËR RREGULLIMIN DHE PËRCAKTIMIN E PËRKRAHJES FINANCIARE TË OJQ-
ve GJATË VITIT 2007**

Neni 1

Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohen dhe përcaktohen kushtet dhe mënyrat e përkrahjes financiare (subvencionet) për Organizatat Joqeveritare vendore, aktiviteti i të cilave ndërlidhet me fushëveprimin e MPMS. Kjo përkrahje vlen për vitin 2007, ndërsa mjetet ndahen nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

Neni 2

Me qëllim të realizimit të projekteve të caktuara që ndërlidhen me fushëveprimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkrahje financiare mujore për vitin 2007 nga mjetet buxhetore të kësaj Ministrie do të përfitojnë këto OJQ:

- Shoqata humanitare bamirëse “Nëna Terezë”..... 3000 € në muaj
- Shoqata e të burgosurve politik.....2000 € në muaj
- Organizata e pensionistëve të Kosovës..... 750 € në muaj
- Sindikata e pensionistëve të Kosovës.....750 € në muaj
- Organizata e invalidëve të punës.....750 € në muaj
- Shoqatat e dala nga lufta 6000 € në muaj
- Shoqata e të verbërve ...1000 € në muaj
- Shoqata e personave me aftësi të kufizuara “Handikos”.....750 € në muaj
- Shoqata e personave me hendikep dhe aftësi të kufizuara të Kosovës
..... .750 € në muaj
- Organizata e prindërve me fëmijë me aftësi të kufizuar, OPFAKKOS
.....500 € në muaj
- Shoqate e Personave me paralizë të fëmijëve Handicap-Kosova.....500 € në muaj.

Neni 3

Përkrahja financiare nga mjetet buxhetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, bëhet për të ndihmuar funksionim të zyrave në nivelin qendror të këtyre OJQ-ve, në përputhje me fushëveprimin e tyre të përcaktuar me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore

Neni 4

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në dhjetor të vitit 2007, do të kërkojë raport në formë të shkruar nga OJQ-të e përmendura më lartë, lidhur me arsyetimin e mjeteve financiare të shpenzuara.

Neni 5

Pagesat mujore për mbështetje financiare të OJQ-ve të përmendura më lartë, do të realizohen nga mjetet buxhetore të Departamentit të Mirëqenies Sociale në MPMS.

Neni 6

Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ do të jenë Marrëveshjet e Mirëkuptimit të lidhura në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me këto OJQ, në përputhje me kërkesat e tyre për përkrahje financiare.

Neni 7

Për zbatimin e drejtë dhe efikas të këtij Udhëzimi Administrativ do të përkujdeset Drejtori Ekzekutiv Financiar i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

Neni 8

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa do të zbatohet nga 01.01.2007.

**Prishtinë,
janar 2007**

Ministri i MPMS

Ibrahim Selmanaj